

Nr. 2360/ Prot.

Durrës, më 17.10. 2025

V E N D I M

Nr. 112, datë 17.10. 2025

PËR

"MIRATIMIN PARAPRAK PËR NJË SHITESË NË STRUKTURËN ORGANIKE TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; në mbështetje të Statutit të UAMD-së, neni 5, pika f; në Rregulloren e UAMD-së; në Vendimin nr. 92, datë 18.09.2025 të Senatit Akademik, në Vendimin nr. 111, datë 17.10.2025 të Senatit Akademik, si dhe referuar relacionit të përbashkët të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit dhe Drejtorisë së Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave me Nr. 2340 prot., datë 16.10.2025 "Relacion për ndryshim në Vendimin Nr. 92, të Senatit Akademik, në funksion të shtesës në strukturën organike për krijimin e "Qendrës së Studimeve Ndërdisciplinore" (bashkëlidhur), Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin paraprak për një shtesë në strukturën organike të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, si më poshtë:
 - 1 (një) Drejtor i Qendrës së Studimeve Ndërdisciplinore, Drejtor / Akademik
 - 3 (tre) Personel akademik të Qendrës së Studimeve Ndërdisciplinore
2. Ky vendim i përcillet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

